

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

Ap. nr. 130/2011

Datë, 28 Shkurt 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Ingo RISCH si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Gunnar Øyhaugen dhe Gjyqtarja Vendore Elmaze SYKA si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Thomas FLANAGAN, në rastin penal kundër,

PASHK KRASNIQI, emri i babait Zef, emri i nënës Zoje, i lindur me 18 Prill 1950 në Nepole, numri i letërnjoftimit 1003355337, Shqiptar i Kosovës, aktualisht jeton në fshatin Nepole të Komunës së Pejës, i martuar, fermer, baba i 11 fëmijëve.

I fajësuar dhe i dënuar me pesë (5) muaj burgim sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë P.nr. 580/10 i datës 29 Shtator 2011, për veprën penale të *Dhënies së Deklaratës së Rrejshme* në kundërshtim me Nenin 307 (1) të KPK-së,

Duke vendosur në bazë të ankesës së të pandehurit, të parashtruar me datë 19 Tetor 2011, në seancën e hapur për publik të mbajtur me 28 Shkurt 2012, sipas Nenit 410, paragrafi 3 të KPPK-së, prani të Prokurorit Publik dhe të pandehurit Pashk Krasniqi, që të dy të ftuar në mënyrë të rregullt

Pas votimit dhe vendimmarrjes së mbajtur me datë 28 Shkurt 2012, lëshon në vijim

AKTGJYKIM

Ankesa e të pandehurit Pashk Krasniqi REFUZOHET si e pabazuar dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë P.nr. 580/10 i datës 29 Shtator 2011 KONFIRMOHET.

ARSYETIM

1. Prapavija Procedurale

Apeluesi Pashk Krasniqi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë në lidhje me vendimin e një gjyqtari të EULEX-it në Gjykatën Komunale në Pejë me datë 29 Shtator 2011 (Lënda numër P. Nr. 580/10). Seancat dëgjimore të shqyrtimit kryesore në Gjykatën Komunale janë mbajtur me 26 dhe 29 Shtator 2011. Në ato data parashtruesi i ankesës u akuzua për Dhënien e Deklaratës së Rrejshme në kundërshtim me Nenin 307 të KPK-së.




supozohej të kishte ndodhur me datë 24 Prill 2009 gjatë shqyrtimit kryesor të Gjeloš Krasniqit për veprat penale të krimeve të luftës. Gjyqtari i Shkallës së Parë e fajësoj ankuesin për veprën penale të Dhënies së Deklaratës së Rrejšhme dhe e dënoj atë për një periudhë kohore prej pesë muaj burgim. Pashk Krasniqi parashtroi ankesë me datë 19 Tetor 2011.

2. Aktgjykimi i shkallës së Parë P.nr. 580/10

Pashk Krasniqi nuk ka dhënë dëshmi Gjykatës së Shkallës së Parë. Para mbajtjes së shqyrtimit kryesor ai deklaroi se dëshmia që ai ka dhënë në gjykimin e Gjeloš Krasniqit me datë 24 Prill 2009, ka qenë e vërtetë. Në atë datë, ai ka theksuar se natën e 24 Marsit të vitit 1999 dhe në mëngjesin e 25 Marsit të vitit 1999 ai ka qenë prezent me Gjeloš Krasniqin dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së në shtëpinë e tij në fshatin Nepole. Ai ka deklaruar se Gjeloš Krasniqi ishte i caktuar me detyrat e kuzhinës. Pashk Krasniqi dëshmoi se ai ishte përgjegjës për të organizuar shërbimet e rojës së fshatit. Ai deklaroi se Gjeloš Krasniqi mund të largohej nga fshati vetëm me lejen e tij. Në fakt ai deklaroi se gjatë periudhe kohore prej 20 Marsit deri me 4 Prill 1999 Gjeloš Krasniqi nuk doli nga fshati fare. Ai dëshmoi se ishin gjashtë veta duke përfshirë edhe Gjeloš Krasniqin prezent me te në shtëpinë e tij në natën e 24 Marsit 1999. Ai tha se qëndruan zgjuar atë natë deri në orën 2 të mëngjesit duke festuar fillimin e bombardimeve të NATO-s. Ai dëshmoi se Gjeloš Krasniqi dhe Kole Krasniqi ngelen me te deri në ora 10 te paradites të datës 25 Mars 1999. Pashk Krasniqi është ri-pyetur me datë 24 Prill 2009. I është thënë se gjatë shqyrtimit kryesor të Gjeloš Krasniqit dëshmitarët e prokurorisë kishin dëshmuar se ai, së bashku me ushtarët e UÇK-së kishin qenë në fshatin Doblbare të Komunës së Gjakovës natën në fjalë. Pashk Krasniqi nuk mund të sqaronte këtë gjë. Pashk Krasniqi deklaroi se grupi ishte i zgjuar duke festuar në shtëpinë e tij deri në orën 2 të mëngjesit. Kjo u kundërshtua me dëshminë e Kole Krasniqit i cili deklaroi se grupi ishte zgjuar deri në orën 7 të mëngjesit. Pashk Krasniqi nuk mundi ta sqaronte këtë. Pashk Krasniqi dëshmoi se Gjeloš Krasniqi ishte i pranishëm në fshat kur ai shkoi të inspektonte rojet atë mëngjes. Ai ra në kundërshtim me dëshminë e Kole Krasniqit i cili dëshmoi se Gjeloš Krasniqi u zhduk gjatë asaj nate dhe se nuk e kishte parë më atë. Pashk Krasniqi nuk mundi të jepte sqarim për këtë gjë. Pashk Krasniqi dëshmoi se Gjeloš Krasniqi nuk kishte të veshur uniformë natën në fjalë. Kjo u kundërshtua nga dëshmitari i prokurorisë i cili përshkroi Gjeloš Krasniqin të veshur me uniformë. Përsëri, Pashk Krasniqi nuk mundi të jepte sqarim për këtë gjë. Pashk Krasniqi u përpoq të portretizonte Gjeloš Krasniqin si një kuzhinier të thjeshtë. Dëshmitë treguan se ai ishte çdo gjë përpos kuzhinier. Në disa raste të rëndësishme dëshmi të Pashk Krasniqit para gjykatës me datë 24 Prill 2009 janë kundërshtuar edhe nga prokuroria edhe nga dëshmitarët e mbrojtjes. Pashk Krasniqi nuk ishte në gjendje të sqaronte asnjë prej këtyre kundërshtimeve dhe dëshmia e tij mbi të gjitha ishte tufë gënjeshtresh e sajuar për të siguruar një alibi të rreme për Gjeloš Krasniqin.

3. Ankesa

Gjykata e Shkallës së Dytë ka pranuar parashtrësë me shkrim nga ankuesi. Me datë 17 Tetor 2010. Këto parashtrësë ishin ndarë në tri kategori kryesore. Fillimisht ankuesi parashtroi se Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur dispozitat e KPPK-së. Së dyti, ai argumentoi se kjo Gjykatë



ka shkelur dispozitat e KPK-së, dhe së fundi se ka nxjerrë përfundime të gabuara sa i përket fakteve të cilat nuk janë arsyetuar mbi bazat e dëshmive që i ka dëgjuar. Në mënyrë që të shmang përsëritjet Gjykata e Shkallës së Dytë i referohet përmbajtjes së ankesës. Në seancën dëgjimore të Shkallës së Dytë ankuesi nuk u zgjerua në parashtrësën e tij me shkrim. Në vend të kësaj ai bëri një parashtrim të stërzgatur lidhur me pjesëmarrjen e tij në luftën në Kosovë, veprimet e tija që nga ajo kohë si dhe gjendjen e tij të tanishme ekonomike. Këto parashtrësia nuk kishin të bënin me faktet në fjalë. Trupi gjyqësor e pyeti nëse ai kërkonte të parashtronte ankesë fajësisë dhe dënimit. Ankuesi deklaroi se ai nuk ishte fajtor dhe donte të parashtronte ankesë kundër fajësisë dhe dënimit. Lidhur me fajësinë, e vetmja parashtrësë e tij ishte se ai kishte mbajtur ditar gjatë gjithë kohës së luftës. Ai deklaroi se kjo përmbante një hyrje mbi ngjarjet e natës së 24 Marsit 1999 e bere brenda 24 orësh. Megjithatë, ai deklaroi se nuk i referohet ditarit të tij kur dha dëshmi me datë 24 Prill 2009 sepse ngjarjet e 24 Marsit 1999 ishin aq të rëndësishme dhe se ato i mban mend aq qartë dhe nuk do ti harroj asnjëherë.

4. Gjetjet e Gjykatës së Qarkut


a) Gjetjet faktike

Së pari, Gjykata e Shkallës së Dytë ka gjetur se të vetmet argumentet të parashtruesit të ankesës janë ato nga parashtrësia e tij e datës 17 Tetor 2010. Parashtruesi i ankesës nuk ka bërë ndonjë argumentim relevant në seancën para Gjykatës së Shkallës së Dytë me datë 28 Shkurt 2012. Gjykata e Shkallës së Dytë nuk gjeti nga asnjëra nga argumentet e bëra lidhur me çështjen faktike të ishin të mjaftueshme për ti hedhur poshtë gjetjet e Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Shkallës së Dytë gjen se argumentet e parashtruesit të ankesës ishin të arsyetuara dobët, nuk i kanë adresuar gjetjet e Gjykatës Komunale në asnjë mënyrë lëndore dhe kanë qenë përfundimisht jo bindëse. Gjykata e Shkallës së Dytë ka konfirmuar gjetjen e Gjykatës Komunale, dhe në fakt, me 24 Prill 2009, gjatë dhënies së dëshmisë gjatë gjyqimit të Gjeloš Krasniqit, parashtruesi i ankesës Pashk Krasniqi ka bërë deklaratë të rrejshme duke thënë se Gjeloš Krasniqi ka qenë me të në shtëpinë e tij në fshatin Nepole natën e 24 Marsit 1999 dhe mëngjesin e 25 Marsit 1999. Gjykata e Shkallës së Dytë po ashtu ka gjetur se në të vërtetë parashtruesi i ankesës Pashk Krasniqi, e ka bërë deklaratën e tij në mënyrë që të ofrojë alibi të rrejshme për personin e akuzuar Gjeloš Krasniqi.

b) Gjetjet ligjore

Gjykata e Shkallës së Dytë ka ekzaminuar ankesën në përputhshmëri me dispozitat e Nenit 415 paragrafi 1, (1) deri (4) të KPPK-së dhe ka gjetur se, në kundërshtim me parashtrësia e parashtruesit të ankesës, nuk ka pasur shkelje të dispozitave të Nenit 403, paragrafi 1, pika 12 apo Neni 403, paragrafi 2, pikat 1 dhe 2 të KPPK-së gjatë mbajtjes së shqyrtimit kryesor të parashtruesit të ankesës para Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka qenë e përbërë në mënyrë të duhur dhe gjyqtari i Shkallës së Parë nuk ka qenë i diskualifikuar.



Në lidhje me pikat e ndryshme të ankesës, gjykata e shkallës së dytë ndjek numërimin e njëpasnjëshëm të parashtruesit të ankesës në letrën e tij të ankesës së datës 17 Tetor 2010 dhe gjen si në vijim:

1.

Sa i përket ankesës së parashtruesit të ankesës, se Neni 403 KPPK-së ishte shkelur, është sqaruar e kundërta, shikoni më lartë.

1.2

Sa i përket pohimeve të parashtruesit të ankesës se pretendimet e paraqitura në aktakuzë nuk janë të dokumentuara me asnjë provë të qëndrueshme, është treguar e kundërta, shikoni më lartë.

1.3

Sa i përket argumentimeve të parashtruesit të ankesës se aktgjykimi i Shkallës së Parë nuk ka të bëjë me dispozitivin e aktakuzës PP.nr. 1644/2009 të datës 3 Mars 2009, ai e ka gabim dhe se e kundërta tashmë është treguar. Shikoni më lartë

1.4.

Sa i përket çështjes që parashtruesi i ankesës e argumenton se nuk ka prova materiale apo të rëndësishme që dëshmojnë se ai ka vepruar në mënyrë joligjore apo se asnjë nga veprimet e tija tregojnë ndonjë element të veprave penale për të cilat ai akuzohet ai e ka gabim dhe se e kundërta është treguar tashmë, Shiko më sipër.

1.5.


Sa i përket argumentimit që parashtruesi i ankesës bënë se Gjykata e Shkallës së Parë ka injoruar të vërtetën lidhur me faktet dhe provat e sjella në gjykatë, është treguar e kundërta gjë, shiko më lartë.

1.6.

Sa i përket asaj që parashtruesi i ankesës argumenton se dënimi i vënë nuk është në proporcion me natyrën e veprës penale për të cilën ai është dënuar, arsyetimet e trupit gjykues për të mos pranuar që të ndërhyj në dënimin e vënë nga Gjykata e Shkallës së Parë paraqiten këtu më poshtë. Trupi gjykues ka vendosur që vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë nuk bie në kundërshtim me Nenin 64,66 dhe 67 të KPK-së siç supozon parashtruesi i ankesës.

Shkresat e parashtruesit të ankesës nuk i adresohen ndonjë gjetjeje të veçantë të Gjykatës së Shkallës së Parë për të cilën ai është gjetur fajtor. Ai po ashtu nuk adresoj ndonjë prej këtyre gjetjeve para Gjykatës së Shkallës së Dytë. Sepse ai nuk paraqiti argumente të tjera dhe thjeshtë kërkon të lirohet, e që nuk meritohet me ligj, në fakt fajësia e parashtruesit të ankesës është konfirmuar.

Në lidhje me ashpërsinë e dënimit, Gjykata e Shkallës së Dytë nuk gjeti arsye të mjaftueshme që të zbus dënimin e shkallës së parë, prandaj ka vendosur sipas detyrës zyrtare si në vijim.



- a) Një dënim prej 5 muajsh burgim është brenda kornizave të ligjit dhe Gjykata e Shkallës së Dytë nuk e gjen këtë dënim që të jetë shumë i ashpër, sepse Neni 307 KPK-së parasheh një gjobë apo një dënim deri në një vit. Për ta dënuar me gjobë parashtruesin e ankesës apo që ti epet një dënim më i lehtë për më pak se 5 muaj burgim, nuk mund që të arsyetohet nga aspekti i qëllimit të dënimeve, sepse kjo nuk do ta pengonte kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen. Një zvogëlim i dënimit mund të merret nga ana e parashtruesit të ankesës si një ftesë që të vazhdojë me përsëritjen dhe dhënien e dëshmimeve të rrejshme në të ardhmen.
- b) Parashtruesi i ankesës po ashtu nuk e meriton një zvogëlim të dënimit duke urdhëruar një pezullim të shërbimit prej 5 muajsh burgim. Në lidhje me këtë Gjykata e Shkallës së Dytë është dashur që ta marrë parasysh se Gjeloš Krasniqi ka qenë i akuzuar me krime të rënda të luftës dhe parashtruesi i ankesës, duke ofruar alibi të rrejshme, ka pasur për qëllim që të pengojë që i akuzuari të gjendet fajtor për krime kaq të rënda.

Lidhur me qëllimet e mëtejme të dënimit, për të frenuar personat e tjerë nga kryerja e veprave penale (shiko Nenin 34(2) të KPK-së), trupi gjykues ka vendosur që një dënim me kusht do të ishte një vendim i padrejtë në këtë rast, sepse gjykata në të shumtën e rasteve të procedurave penale mbështetet në dëshmitarë të besueshëm prandaj vënia e një dënimi me kusht do të dërgonte tek publiku një sinjal të gabueshëm. Po ashtu edhe krahasimi me bashkë të akuzuarin e parashtruesit të ankesës, i cili ka marrë një dënim me kusht, nuk shpie në një gjykim tjetër, sepse deklarata e tij ka qenë e një rëndësie të vogël në krahasim me atë të parashtruesit të ankesës, i cili jo vetëm që ka dhënë deklaratë të rrejshme por ka shkuar edhe më tej dhe ka sajuar një alibi të rrejshëm në përpjekje për ta mbrojtur Gjeloš Krasniqin.

Andaj është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, AP.nr. 128/11 e datës 28 Shkurt 2012

Anëtar i Panelit

Gunnar Øyhaugen

Anëtar i Panelit

Elmaze SYKA

Anëtar i Panelit

Ingó RISCH

